



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më 19.09.2022 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. “UÇK”, nr. 2.
Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti i punës së Kryetarit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023;
4. Propozimvendimi lidhur me Kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2023-2025;
5. Informatë për raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe plani i zbatueshmërisë për të gjeturat e këtij raporti;
6. Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të: Flora (Hasan) Çunajt, Arta (Nysret) Maliqit, Fatima (Hamit-Vej Nusret) Maliqit, Hana (Nysret) Maliqit, Arbëresha (Adem) Maliqit, Nevzat (Adem) Maliqit, Nexhat (Adem) Maliqit, Nakije (Nysret) Morinës, Nazan (Adem) Maliqit, Selamete (Hasan) Maliqit, Mevlyde (Hasan) Maliqit, Zana (Hasan) Sejdiut, Albulena (Hasan) Maliqit, Maliq (Abdul) Maliqit, Mihibe (Hasan) Makollit, Gëzim (Hasan) Maliqit dhe Luan (Nysret) Maliqit;
8. Projektregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, dt. 06.06.2018;

9. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga kategoria e subvencioneve të administratës në kategorinë e subvencioneve të Drejtorisë së Arsimit;
10. Propozimvendimi për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civilë të Komunës së Prishtinës;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-205950/22, më 06.09.2022

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kujtim

